

**ARJANA SEITI**

**E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT...  
NJË SUBJEKT FETAR I SHKRIMTARIT MITRUSH KUTELI  
NË VËSHTRIM ANTROPOLOGJIK**

Objekti i studimit

Tekstet letrare veçohen prej njëri-tjetrit për faktin e vetëm se sa unik janë apo mbeten. *E madhe është gjëma e mëkatit...*, (*Tat Tanushi i Bubutimës*), kështu titullohet novela e Kutelit, shkruar në vitin 1947. Një novelë që shtrihet në tri aspekte të njëpasnjëshme: *Besimi te Zoti; Rebelimi*, sakrilegji [dhunimi vendit të shenjtë, përdhosje]; *Pendesa*.

Novela, ndjek një kronologji ngjarjesh me personazhe të pakta, veprimet shtrihen në pakohësi duke sqaruar ngjarje që kanë ndodhur, shfaqen personazhe kalimtare që nuk lënë gjurmë, këndohen ligjërime të shenjta duke ndikuar tek lexuesi, ndoshta të pakta për dikë, por imponuese për një trajtesë me këndvështrim antropologjik.

Njeriu përgjatë jetës kultivohet nga kulturat popullore ndaj dhe i vë ato në shërbim të shoqërisë, e cila udhëhiqet nga politika e kohës. Kështu që, novela do të shihet në aspektin, jo vetëm të diskursit të njeriut me jetën, por dhe me kulturat dhe politikat e kohës, kur jetoi dhe e shkroi autori. Lexuesi i novelës nuk has dimensione, por autori krijon hapësira intime, imagjinare, duke thurur, falë stilit të tij, kujtesën që do ta veçonim si entitet.

Punimi synon analizën e kësaj novele, duke u nisur nga fjalja e plotë e pa thënë në titull dhe nga qëllimi për të cilën ai shkruan ‘*Dhe ne po e shkruajmë në kartë ashtu si e kemi dëgjuar për të dëshmuar, me anën e tij, fuqinë e hirit - që të lavdërohet emri i Tënëzot në jetën e jetëve*’<sup>1</sup>. Do mundohemi të aludojmë rreth një parandjenjeje të Kutelit, duke lidhur tekst-kontekst me kohën kur shkroi dhe jetoi autori.

Shkrimtarët e letrave zakonisht lënë pikëpyetje për t’u nënkuptuar, kështu që novelën mund ta lexojmë përveçse në formatin e një trajtese fetare pastërtisht letrare edhe në këndvështrime të tjera, ashtu siç ka

---

<sup>1</sup> M. Kuteli, 2006, *E madhe është gjëma e mëkatit...*, Botimi III, f. 11.

ndodhur me shumë botime letrare, që ka njohur koha dhe që janë trajtuar nga studiuesit apo kritikët. Duke qenë një vepër letrare, mendoj se në të do të gjente mbështetje edhe filozofia e Nietzches se *poeti realisht është zëri i popullit, ai konsiderohet si zëri i Zotit*<sup>2</sup>, duke ruajtur kështu në krijimet e tij gjuhën e pasur dhe forcën e mendimit mitologjik.

Kështu, në fokus do të jetë një analizë që na jep mundësitë për të na ndritur mendjen e për të na shuar kureshtjen se cila është *gjëma*. Do të mundohemi ta interpretojmë këtë novelë, për të thënë se, nëse një shkrimi i kthehesh së lexuari më shumë se dy herë, do të thotë, se vërtet përveç triumfit të dashurisë, të cilin ai e ka deklaruar në novelë<sup>3</sup>, ndoshta mes kësaj rrëfenje, ka edhe diçka tjetër të pathënë prej tij, ashtu siç ndodh në një vepër letrare duke na lënë në lexuesve në udhëkryqe mendimesh e ndoshta duke ndjekur thënien e Volterit se *'sekreti për të qenë i mërzitshëm është që të thuash gjithçka'*<sup>4</sup>.

#### Mendime rreth stilit dhe krijimtarisë së Kutelit

Për Akademikun Alfred Uçi *"krijimtaria e Kutelit është ekzistencë në kapërcyellin e botës së vjetër në perëndim dhe pasigurisë nga paralëjmërimet e një kohe të re, të panjohur e frikësuese, që po trondiste themelet e patundura të jetës patriarkale"*<sup>5</sup>. Studiuesi Uçi edhe pse nuk ndalet veçmas tek novela të cilën kemi marrë në shqyrtim, i sheh motivet dhe subjektet e Kutelit të lidhura ngushtësisht me motivet dhe subjektet e folklorit shqiptar, të cilat nuk kalojnë pa prekur temat sociale apo jetën e njeriut në situata ekzistenciale. Sipas tij *"heronjtë e Kutelit vdekjen e natyrshme e kërkojnë vetë ose e presin pa frikë, sepse ndjejnë se e kanë jetuar jetën, e kanë kryer detyrën e duhet të largohen me kohë për të mos iu rënduar"*<sup>6</sup>.

Në lidhje me artin e të shkruarit për Kutelin, kemi përzgjedhur një vlerësim të Visar Zhitit: *"Ai dhe Ernest Koliqi janë themelues të prozës*

<sup>2</sup> F. Nietche, *Udhëtari dhe hija e tij*, Tiranë 2001, f. 74.

<sup>3</sup> Lëçitësit mundet të mos i pëlqejë një gjëmë e tillë po neve preps [duhet] ta themi si pat qenë, pa shtuar e pa pakësuar gjë. Dhe në qoftë se ay nuk ze besë i kujtojmë se është thënë: 'dashuri, sa më shumë pi nga mburimi yt, aqë më shumë et kam! Kjo gjë i afrohet shumë së vërtetës'; M. Kuteli, 2006, f. 15.

<sup>4</sup> A. Shopenhauer, *Metafizika e Dashurisë*, Phoenix, 1995, f. 54.

<sup>5</sup> A. Uçi, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi [N. Frashëri, Gj. Fishta, F. Konica, M. Kuteli, Migjeni]*, 'Krijimtaria letrare e Mitrush Kutelit dhe lidhjet e saj me folklorin', Shkup, 2003, f. 146.

<sup>6</sup> A. Uçi, *po aty*, f. 151.

*moderne shqiptare, mbartës jo vetëm të fjalës, por edhe të zërit, të Veriut dhe Jugut, të vendit të lashtë Ballkanik. Bashkë me Lasgush Poradecin, mikun e tyre qiellor, që Kuteli e botoi së pari, përbëjnë trininë nismëtare të letërsisë moderne shqiptare, ata e sollën të parët shekullin XX artistikisht në truallin tonë*<sup>7</sup>.

Pasi lexova novelën, m'u desh t'u hidhja një sy kritikave letrare gjatë periudhës së realizmit socialist, nga ku krijova iluzionin, që nëse novela do të botohej në kohën e sistemit monopartiak, shumë shpejt, kjo vepër letrare, do të zhdukej nga qarkullimi, apo do të trajtohej si një vepër, ku loja me troparet e shenjta e çorodit ideoartistikisht lexuesin.

#### Jeta dhe novela e Kutelit

Dhimitër Pasko jetoi për 22 vjet më radhë në Rumani, mbron doktoraturën në fushën e sistemit bankar dhe kthehet në Shqipëri në vitin 1942. Si nëpunës i shtetit rumun i nënshtrohet mobilizimit ushtarak. Tetori i '44-ës, do ta gjente në radhët partizane. Më 1945, zgjidhet në Kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve, njëkohësisht nëndrejtor i Bankës së Shqipërisë. Një udhëtim i tij në Jugosllavi, do të bënte që, përgjatë viteve '47-'49, të gjendet mes hekurave të burgut<sup>8</sup>.

Me pakënaqësitë që e rrethojnë, si një rrëfimtari që ndjek rrëfimin dhe jo rrëfimi atë, nuk do ta kishte të lehtë karrierën dhe jetesën që mezi arrinte ta përballonte, duke e konvertuar shkrimtarin në një përkthyes, për t'i shpëtuar përndjekjes, të cilën nuk mundi ta shmangë pa një dramë familjare. Duhet të sjell në vëmendje, që një arrestim i atyre viteve, do të thoshte bastisje apo sekuestrim, të cilëve nuk mund t'i shpëtonin dorëshkrimet apo arkivi personal i tij, sado të kujdeshëm të tregoheshin pjesa tjetër e familjes, e cila gjithashtu ndiqej nga internimi.

Duke u nisur nga kjo që thamë më sipër, mendojmë se, novela për të cilën ne po shkruajmë, nuk do të mund t'i shpëtonte dot bastisjes. Përkimi i vitit të shkrimit të novelës, me vitin e burgosjes së tij, na bëjnë skeptik, kur flasim rreth datës së shkrimit.

Duke veçuar dhe përçuar shprehjet me taban popullor, Kuteli paraqet gjendje emocionale dhe njohje dëshirash, të cilat të bëjnë të mendosh se përreth gjithë ngjarjes ekzistojnë vetëm njerëz të mirë. Më poshtë, do të ofrojmë shkurtimisht novelën, por pa dyshim që lexuesi nuk duhet të

---

<sup>7</sup> V. Zhiti, *Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar*, Tiranë, 2010, f. 103.

<sup>8</sup> Shih më gjërësisht: *Shtegtim në jetën dhe veprën e Mitrush Kutelit*, Tiranë, 2009.

humbë fatin e leximit të kësaj rrëfenje, ku gjuha e popullit dhe stili i Kutelit zor se do të dëgjohet dhe të shkruhet në kësi kohrash.

Në një *katunt* të Ilirisë, një prift ortodoks Tanushi, pasi kishte mësuar mjeshtërinë e korave të shenjta në detet e Lindjes, merr hirin e priftërisë. Kalija, vajza e Judhesë kurorëzohet me Tanushin dhe kjo iu ish shkrojtur si vepër e mirë në Librin e jetës. Ai i mëson asaj ëmbëlsinë e fesë së re, e ajo atij fuqinë e fesë së vjetër, të cilat sipas Kutelit që të dyja u bënë një, duke na kthyer në proverbin universal burrë e grua mish e thua. Kjo duket qartë në deklaratën që i bën të shoqes “... dhe s’ka tjetër gjë as në dhe, as në qiell, as në ujra që ta dua sa ty...”<sup>9</sup>. Por, a ishte kjo, ajo ç’ka i kërkohej shërbëtorit të betuar të kishës?

Autori me pak fjali arrin të japë qartë mallin dhe melankolinë që ka pushtuar të bukurën e Judhesë. “*Dhe kurmi i saj kish mbledhur gjithë erërat e dheut, të barit e drurëve të Judhesë*” [f. 20].

Në ëndërr Tanushit i fanitet Krishti me kurorë drite rreth kryes i veshur me të shenjtat e meshës, teksa i këndonte Kalijes të kënduarat e vdekjes. Përgjatë ëndrrës prifti Tanush reagon dhimbshëm “*qau me zhurmë sa kumbojti gjithë kisha...*” [f. 24].

Një vit më vonë Kalija në pranverë vdes me dhimbjen e trupit dhe dhimbjen e shpirtit se *trupi i saj s’lidhi fëmijë*. Tanushi nisi t’i mbante mëri Zotit për vdekjen e së shoqes. Pas vdekjes së Kalijes korat e tij morën fytyrën e saj, duke e larguar atë nga i Madhi i jetës *për një dorë eshtra e për fytyra të bëra me dru*, - thotë Kuteli. Shembja e madhe ndodhi kur trupi i tij njohu trup gruaje. Pas kësaj, sipas kanuneve të Kishës ai s’duhej të meshonte as asaj dite, as në ditë të tjera, gjer sa trupi e shpirti e tij të pastroheshin me rrëfim, agjërim e pendim të vërtetë. Por, ai hyri në meshë dhe kjo iu numërua si mëkat, e nga Zëri mallkohet kurrë mos vdeksh. Kështu ai ndërmerri një udhëtim pa kohë pa vend, por me qëllimin e pastrimit shpirtëror.

Në ëndërr teksa dremiste, Tanushit i flet zhurma e valës “*Ngreu e shko ku do t’te thërresën, sepse ditët e tua u nëmëruan*”<sup>10</sup>. Në rastin e Tanushit, nuk ka më paralajmërim, ngjarja po ndodh, vdekja po vjen.

Pas fjalës Anaksios ai kërkon *falje*, duke i dhënë kësaj fjale që jo rrallë e quajmë magjike, peshën dhe fuqinë e zgjidhjes së mallkimit. Më pas, autori përshkruan, se si trupi i tij u tret ngadalë, duke mbetur veçse një dorë hi, në pragun e derës së shenjtë.

<sup>9</sup> M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit...*, f. 20.

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 42.

### Studiuesit për novelën

Do të donim të sqaronim lexuesit, se në referencat tona rreth kësaj novele, kanë qenë punimet e ndërmarra me karakter antropologjik.

Teksa ndalet në studimin e novelës së Gjëmës..., studiuesi Aurel Plasari<sup>11</sup>, sugjeron se, për Kutelin, viti 1944 mund të çkodohet si një vit orvatjesh për t'iu kthyer sërish artit. Novelën e interpreton si ngjarjen e jetës së tij, ku përkohet me moshën dhe peripecitë problematike përgjatë jetës. Prozën rrëfimore të tij e përfytyron si dialog mes dy shpirtrash dhe mes dy botësh.

Studiuesi Eldon Gjika<sup>12</sup>, duke u nisur nga një gjetje e mprehtë e Kolevicës<sup>13</sup> e argumenton novelën e Gjëmës... si një hipotekst të legjendës së Hebreut shëtitës, të rrëfyer prej autorit jo vetëm për shkak të njohjes apo përhapjes së kësaj legjende, por edhe për shkak të teksteve religjioze, të cilat vijnë në simbiozë me rrëfimin popullor.

Si dukuri e pazakontë, apo si lojë mes hapësirës dhe kohës, trajtohet kjo novelë, nga studiuesi Spiro Gjoni, ku komunikimi kohë-hapësirë shpërthen kufizimet dhe pengesat me qëllimin për të jetuar lirinë pakohë e pavend<sup>14</sup>.

### Një vështrim antropologjik

Kanti thotë: “Antropologjia është teoria e njohjes së njeriut ... në këndvështrimin fiziologjik dhe pragmatik. Njohja fiziologjike e njeriut synon të zbulojë se çfarë bën natyra me njeriun, kurse njohja pragmatike synon të gjurmtojë atë se çfarë bën, mund të bëjë apo duhet të bëjë njeriu si qenie e lirë për të vepruar”<sup>15</sup>. Kjo teori e Kantit do të bëhet udhërrëfyesja e këtij punimi, ku filozofia e jetës do të zbërthehet përmes mitologjisë dhe teologjisë, si dy fusha tepër të lidhura me njëra tjetrën, pa të cilën bota letrare nuk mund të përparojë. Interpretimi i disa prej teksteve qoftë dhe religjioze në novelë, do të na kthejnë tek e përditëshmja, tek njerëzoria, tek jeta.

Le t'i kthehemi novelës, ku fjalë e plotë që pasohet në brendi vijon: “E madhe është gjëma e mëkatit, po e madhe edhe fuqia e hirit të priftërisë”. E lënë nga autori, ndoshta jo pa qëllim e papërfunduar, mund të

---

<sup>11</sup> A. Plasari, *Kuteli mes të gjallëve dhe të vdekurve*, Tiranë, 1995, f. 92.

<sup>12</sup> E. Gjika, *Prania Historike dhe shpëtimi i hebrenjve gjatë Luftës*, ‘Motivi i hebreat shëtitës në tekstin e Kutelit’, f. 178-184.

<sup>13</sup> M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit...*, 2006, Botimi III, f. 5-7.

<sup>14</sup> S. Gjoni, *Shtegtëm në jetën dhe veprën e Mitrush Kutelit*, Tiranë, 2009, f. 60.

<sup>15</sup> Kant, *Digital Bibliothek of Philosophy*, Berlin, 2000, f. 197.

ishite një sqarim i tillë për lexuesin: sado i madh të jetë mëkati (vrasje, përdhunim, sakrilegj, lakmim i gruas së tjetrit), hiri i Perëndisë e zhbën atë. Një fjali e plotë në titull: A do ta lartësonte shkrimtarin si një besimtar të denjë ortodoks? A kërkohet nga pushteti i asaj kohe kjo që po themi, apo kërkohet që jeta dhe vepra t'i përkushtohet Partisë? Të mos harrojmë, që kjo ideologji kishte nisur të hidhte rrënjë ngado. Që në nisje të novelës deklarohet prej autorit, se ngjarjen e kish dëgjuar nga më të moçmit, por ndërkohë askush nuk rrëfeu ndonjë prej këtyre legjendave. Mendoj se ekzistenca e dy legjendave vihet në pikëpyetje, dhe se autori mund të ketë krijuar, le të themi një lloji alibie, krejt e pranueshme, kur është fjala për të bërë art fjale.

- Tematika fetare e novelës, në kontekstin e regjimit komunist

Për të kuptuar rezonancën e temës së zgjedhur nga Kuteli, mund të përshkruajmë shkurtimisht kontekstin politik mes qeverisë dhe fesë, fill pas Luftës së Dytë Botërore. Shteti i ri komunist u afirmua si shtet laik, ku qytetarëve iu garantohej liria e besimit, por i ndalohej shfrytëzimi i kishës dhe i besimit për qëllime politike. Atezimi si ideologji kishte kohë që qarkullonte nëpër vëndet socialiste dhe shumë shpejt do të shtrihej edhe në Shqipëri. Qëndrimi i pushtetit të asaj kohe ndaj klerikëve fetarë rezultoi agresiv për disa arsye: antikomunizmi i klerikëve katolikë dhe ortodoks, bashkpunimi i një pjese të vogël klerikësh me pushtuesit aktualë, si dhe vështrimi i kishës si një monopoliste që duhej shpronësuar.

Feja, ende në ato vite kur u shkruajt kjo novelë, nuk ishte e ndaluar, por shumë shpejt do të konsiderohej nga komunistët si opium ideologjik<sup>16</sup>.

Duke qenë se novela i përket sferës fetare, do mundohemi të kujtojmë disa prej koncepteve mbi fenë, të cilat variojnë sipas shoqërive, sistemeve kulturore, epokave historike, disiplinave shkencore dhe subjekteve.

Kështu antropologët e vendosin fenë tek sfera e së shenjtës, pikërisht për këtë do t'iu referohemi disave prej tyre: Chriss Hann-i<sup>17</sup> e trajton komunizmin si një besim fetar, ku themeluesit e tij interesohen të demaskojnë supersticionin, që zë një shtrirje përgjatë gjithë formave të

<sup>16</sup> Për më gjerë shih: A. Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Tiranë, 2012, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

<sup>17</sup> Ch. Hann, *Antropologjia sociale*, 2009, f. 205-211.

fesë. William-i<sup>18</sup> shkruan se feja Ortodokse në Rusi kish dhënë ndihmesë në urtësinë popullore dhe folklorin rus, duke ofruar një simbol të identitetit kombëtar edhe për ata që ishin të shkujdesur në lidhje me respektimin e fesë. Tylor<sup>19</sup> në sferën e religjionit mbronte tezën e mbijetesës së ritualeve apo besimeve edhe pse domethënia e tyre mund të ishte bjerrë. Studiuesi Alan Barnard<sup>20</sup> thekson bartjen e kulturave, të popujve, të vendeve nga njëri tek tjetri, ku nuk përjashton as qasjen regjionale.

Përsa i përket filozofëve kemi shkëputur një fragment nga Nietzsche i cili thotë: “*Detyra jonë nuk është më ajo që t’u mësojmë njerëzve se çfarë është era e jugut: ata kanë Moisiun dhe profetët e kohës për t’i ndriçuar. Nëse nuk duan t’i dëgjojnë atëherë...*”<sup>21</sup>

Një rrëfim si ky, që zotëron dhe kultivon një traditë gojore të mveshur mjeshtërisht me ligjërimet e shenjta të Shkronjës, do të nxiste tek ne disa pyetje: Mos lufta kundër fesë e kish trazuar shpirtin dhe ndjenjën e Kutelit, duke e lënë fjalinë e titullit për fuqinë e madhe të hirit të paplotësuar? A lihet në heshtje për lexuesin me qëllim duke vënë theksin tek gjëma? Ajo çka do të ndodhte, do të ishte një katastrofë? A ishte parashikuar nga Kuteli lufta ateiste, që do të gllabëronte edhe Shqipërinë, megjithëse ai e kish shkruar novelën ‘*E madhe është gjëma e mëkatit...*’, 20 vjet më parë se atdheu i tij të deklarohet si ateist [1967]? A është e saktë data e shkrimit të kësaj novele [1947], kur thuhet se censura dhe peripecitë e jetës qenë të shumta dhe se kjo novelë botohet pas rënies së sistemit komunist? *Gjëma* ka një lidhje vetëm me emrin e vendit ku zë fill ngjarja [Bubutimë sipas autorit, zhurmë që bën deti]? Dhe për mos t’iu kthyer më kësaj fjale të leksikut shqip (kemi parasysh këtu fjalën bubutimë), vendosëm të merrnim në konsideratë një perceptim që ka dhënë Visar Zhiti për gjëmën, por që jemi të bindur që përveç asaj që ai tregon në librin e tij, do të ketë patur në vëmendje edhe këtë novelë të Kutelit: “... *por ajo që fitoi dhe fiton nga gjëma, është vetëm letërsia dhe nëpërmjet saj, kultura, kujtesa kolektive, ndërgjegjja shoqërore, riparimi shpirtëror, mendimi i lirë, universaliteti i ndjenjave dhe e gjitha kjo, si një shpërblim hyjnor që i bëhet vuajtjes njerëzore*”<sup>22</sup>.

---

<sup>18</sup> B. W. Husband, *The Journal of Modern History*, Vol. 70, No. 1, 1998, pp.74-177, *Soviet Atheism and Russian Orthodox Strategies of Resistance, 1917-1932*, 1998, f. 74-177.

<sup>19</sup> A. Barnard, *Historia dhe teoria në antropologji*, Prishtinë, 2011, f. 76.

<sup>20</sup> A. Barnard, *po aty*, f. 95.

<sup>21</sup> F. Nietzsche, *Udhëtari dhe hija e tij*, Tiranë, 2001, f. 219.

<sup>22</sup> V. Zhiti, *Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar*, 2010, f. 171.

A ndërtohet prej autorit, qëllimisht, një vepër letrare, ku deklarohet me ironi *jeta e lidhur vetëm me ekzistencën njerëzore*? A kemi në këtë rrëfim një përgjigje të dilemës së nënshtrimit të Tij vetëm para ZOTIT?

Në kontekstin kulturor shqiptar fjala *fe* shënon botkuptimin, besimin, nderi(mi)n, udhërrëfimin. Prifti i thjeshtë i lutej Zotit për besimtarin, madje i rekomandonte besimtarit që të këndoje edhe himne të shenjta. Por, çfarë po ndodhte me literaturën fetare në Shqipëri përgjatë kësaj kohe? A po përhapej ajo? Apo, po pengohej pikërisht në kohën kur populli shqiptar po zhdukte analfabetizmin? Mos ndoshta, bëhet ky shkak, për të sjellë një vepër letrare me karakter religjioz si ky i Kutelit, kur dihet, se përsa i përket literaturës në lidhje me fetë, Bibla<sup>23</sup> apo Kurani në sistemin monist u trajtuan si ‘librat e verdhë’ [me librat e verdhë nënkuptohej ndalimi i leximit apo qarkullimit], duke thelluar akoma më tej besimin e cekët ndaj Zotit. Mos, ndoshta dogma fetare, po zëvendësohej me doktrinën komuniste, e cila jo rrallë tek shkrimtarët e atyre viteve kërkonte angazhim në shërbim të pushtetit. Mos, ndoshta Kuteli, ka pikasur propagandën komuniste kundër fesë dhe borgjezisë dhe mendon se edhe krimi i tyre mund të falet? Mos ishte kjo një gjëmë?

#### - Shërbëtori i Zotit dhe Besa

Njeriu fetar kërkon një rend ‘gjithpërfshirës’, ‘hyjnor’ dhe e njej dhe e pranor atë me nderim vullnetar<sup>24</sup>. Në thelb, feja kërkon nënshtrimin e vullnetshëm të njeriut ndaj Zotit, megjithëse Tanushi ‘i mësuar fort nuk ish [si ngjet shpesh në shërbëtorët e Kishës së Linjdes], po [si ngjet edhe më shpesh, në gjith atë Kishë], kish besë të madhe në sa janë shkruar e këndohen<sup>25</sup>’, ai vendos që t’i bindet vetvetes. Kuteli thërret: “Ku është vallë besa jote në ngjalljen e dytë?”. Autori e përcakton besën e Tanit; ‘besën në ngjalljen e dytë’, siç ndodh në përcaktimin e besave tek Kanuni i Lekë Dukagjinit, ku flitet për disa lloje besash: besa e gjasë dhe e çobanit mes Nikaj e Curraj, besa e Nikaj dhe e Mërturit, besa e pishtarit, besa e

<sup>23</sup>Studiuesi Fotaq Andrea, më 14 nëntor 2014, f. 20, boton në gazetën shqiptare *Tirana Observer*, artikullin: “Zëri ‘Albania’ si revistë antropologjike franceze e vitit 1876”, me një përmbledhje rreth zërave që botonte kjo revistë, ku prej tij përmendet edhe një detaj rreth përkthimit të Biblës: *Kur u desh të shtypej në Korfuz Bibla Shqiptare me shkronja greke (meqenëse skipëtarët nuk kanë alfabet të shkruar), u desh të shtoheshin nëntë gërma...*

<sup>24</sup>E. Herzog, *Psyche and Death*, 1948, f. 19.

<sup>25</sup>M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit...*, f. 14.

gjahtarit, besa e kostarit, etj.<sup>26</sup>. Kështu në të *Drejtën Zakonore Shqiptare*<sup>27</sup> dhënia e *besës konsiderohet detyrë dhe burri*, ose më saktë do të nënkuptoheshin elementët e virtytit, që në vetvete do të thotë: vlerë, drejtësi, maturi, urtësi. Thyerja e besës për shqiptarët, konsiderohet turp dhe mëkat shumë i madh, që dënohej shumë ashpër. Te Kuteli besa, shenjon besimin tek vendi i shenjtë, në rastin më specifik të novelës shenjon besimin dhe respektin tek Zoti.

Do të ndalem në dy aspekte që përdoren në lidhje me besën: njëra, dhënia e saj dhe tjetra, thyerja. Dhënia dhe thyerja, kanë të bëjnë vetëm me personin që betohet, apo që jep besën dhe jo me atë që e lyp, që jo rrallë tek shqiptarët është kërkuar në mënyrë abuzive. Por, ne do të ndalemi vetëm tek dy termat që sapo përmendëm, të cilët nuk kanë një lidhje mes tyre po të ndiqnim rregullin e antitezës, ku diçka që jepet merret pa patur asnjë arsye që të thyhet. Vetë fjala thyerje të sjell në mendje një copë xhami ose pasqyrë, e cila kur thyhet nuk mund ta kryejë më kurrë funksionin e saj. Kur shqiptari jep besën, ai nuk kërkon mendim dhe kjo mund të quhet një dhënie bese e çastit, por ama për thyerjen e saj, ai do të dënohet nga opinioni, apo institucioni duke bërë që personit t'i humbisnin të gjitha virtytet, sidomos besimi, ca më keq kur është fjala për një klerik. Kështu, nga botkuptimi teologjik, Krishti nuk shikon mëkatet e njerëzve, por BESIMIN e tyre. Sipas Friedrich Nietche "*besimi nuk ka mundur të zhvendosë male të vërtetë, por di të ngrëjë male edhe aty ku nuk janë*"<sup>28</sup>.

Shërbëtori i Zotit ndoshta nuk kishte dije të mira rreth kulturës fetare, pra qarkullonte besimi i cekët e i paqëndrueshëm tek Zoti. Kështu ai bie fajtor përpara Zotit, me mendje, me fjalë e me vepër. Një panoramë e tillë për shqiptarin e thjeshtë synon ta justifikojë distancimin e tij nga stili fetar i të jetuarit duke thënë: besoj në Zot, por jo në fe. Është ndërtuar një raport mes Birit të Zotit, Tanushit, ballë për ballë me Zotin, gjë që ndodh shumë rrallë në shkrime. Pra, kemi përmbysje dhe një pakënaqësi ndaj personave që shërbejnë në këto kisha. Mos, ndoshta shërbëtorët e Zotit, po degradonin misionin e tyre, për të cilin kishin veshur petkun e priftërisë? A po kryhej prej klerikut misioni pnevmatofor [shpirtbartës], që prej Kutelit interpretohet si: *Ato që duken të pamundura me anë të lëndës, bëhen të mundura me anë të frymës*<sup>29</sup>? A është keqinterpretimi i Librit të Shenjtë,

---

<sup>26</sup> Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1972, f. 120-121.

<sup>27</sup> *E drejta zakonore shqiptare*, Tiranë, 1989, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, f. 113.

<sup>28</sup> F. Nietche, *Udhëtari dhe hija e tij*, Tiranë 2001, f. 95.

<sup>29</sup> M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit...*, f. 45.

që e çon Tanushin drejt mëkateve? A trajtohet mëkat, apo gabim njerëzor, për të cilin i jepet kohë, i jepet frymë, i jepet jetë, për ta shlyer atë? Mos vallë besimi i lëkundur i Tanit në Zot do të konsiderohej si *gjëmë*?

- *Takimi me Krishtin*

Në ëndërr Tanushit i fanitet Krishti me kurorë drite rreth kryes i veshur me të shenjtat e meshës, teksa i këndonte Kalijes të kënduarat e vdekjes. Kemi të bëjmë me një ëndërr me karakter profetik, pra parathuhet ajo çka do ndodhë. Njohja dhe të fshehtat e personit që shikon në ëndërr, paraqiten si një nyjë e pazgjidhshme e lidhur mes tij dhe të vdekurit, duke realizuar procesin e inicimit. Ëndrra e Tanit, perceptohet menjëherë, duke i imponuar kundërveprim për të shmangur të keqen e afërt. Takimi me Krishtin në këtë ëndërr, paraqitet pastërtisht pamor. Tanushit i fanitet Krishti ‘me kurorë drite’, bashkëbisedon me Të, por veprimet fizike [ai merr në krahë Kalijen e vdekur prej së cilës mbetet vetëm skeleti], lidhen me njeriun. Le ta interpretojmë në dy rrafshe këtë ëndërr: nga këndvështrimi i besimit apo supersticionit rezulton se njerëzit vetëm në ëndrra mund të komunikojnë me Zotin. Kurse nga pikëpamja racionale mund të thuhet se trupi i gruas po tretej nga dita në ditë.

*Nga malli i shkau mendja t’i hapë varrë* – i numëruar si një nga mëkatet e tij, por që akti nuk u krye. Mëkati i të menduarit ndryshe nga ai i të vepruarit, a kish ndodhur ndonjëherë si ngjarje, prej së cilës rrufeshëm edhe Tanushit mund t’i kalonte nëpër mendje?

Në një këngë folklorike flitet për një kurbetli, që e gjen gruan të vdekur dhe nga malli për ta parë atë, sajon pretekstin: dua të shoh nëse më vdiq me nder apo me turp.

*O shokë më qani hallë,  
Më ka vdekur fati i parë,  
Do vete t’i zbuloj varrë,  
të shoh se ç’nur ka marrë,  
Nur të kuq, a nur të bardhë<sup>30</sup>.*

Ndoshta kjo ndodhi, e cila edhe mund të kishte ngjarë, do t’i renditet si mëkati, i cili mund të shlyhej me falje para korave të shenjta dhe djegies së temjanit, vajit të ullirit e dyllit të bletës.

<sup>30</sup> A. Velianj, *Kushtëzimi artistik këngë-rit në folklor*, “Perla”, 2008/1, f. 79.

- *Djalli në sharm gruaje*

Por, shembja e madhe ndodhi kur prifti i Bubutimës njohu trup gruaje, që prej Kutelit deklarohet si “*djalli që kish marrë asohere fytyrë e shtat gruaje për ta hedhur atë në gjehenë [ferr]*”. Autori i numëron mëkatet e Tanit, për të cilat tregon ndonjë prej rrugëve të larjes së tyre. Ngjarja rrok mëkate njerëzore të pamatura apo të pafrenuara, prej të cilave thyhet besimi, aq sa djalli shfaqet si shpëtim, duke e nisur Tanushin në kërkim të paqes shpirtërore. Po ta shohësh me sy më të ftohtë, është sharmi i gruas-djall, që pas kësaj gjëme, do të spastrojë shpirtin e Tanushit, duke i ndritur mendjen përmes rrugës së oshënarit. Kështu, gjëma, mund të shihet edhe si një ankim i izoluar, një ankim i padukshëm, personal, që nuk del hapur, jashtë mureve.

- *Pelegrinazhi i Tanushit*

Kur Tanushi këmbëngul në *aksios* [i denjë], Zëri ia kthen *anaksios* [i padenjë] duke i shtuar mëkatit dhe mallkimin *aty mbeç* për të marrë nga Zëri mallkimin *kurrë mos vdeksh*. Më pas Tat Tanushi në një mënyrë apo në një tjetër kryen një pelegrinazh individual dhe pastërtisht fetar në kohë dhe në hapësirë “*Mori shkopin e oshënarit në dorë edhe shkoj vënt më vënt, nëpër manastire për pendesë*”. Pas shumë peripecive dhe përpjekjeve të një asketi, i cili tenton për të qenë i lirë dhe i përkryer, zemra e tij bëhet banesë vetëm e Zotit. Dhe çfarë do të nënkuptonte pelegrinazhi i tij? Çdo i krishter duhet të vdesë i kunguar dhe i penduar, pra i pastruar, ndërkohë që kthimi tek rrënoja në Bubutimë, përkon me faktin se jo vetëm toponimet e vendeve të kulteve nuk janë zhdukur, por ende gjenden rrënoja si fakte dhe jo trillime.

Në lidhje me udhëtarët Nietzsche veçon pesë lloje: udhëtarët që nuk e kuptojnë jetën pa udhëtimin, udhëtarët kureshtarë, udhëtarëve të tretë u ndodh diçka ndaj udhëtojnë, të katërtët jetojnë suksesin, të pestët “*janë disa njerëz me forcë shumë të lartë që në fund duhet të bëjnë patjetër që të tjerët të jetojnë atë që kanë parë atë, pasi e kanë jetuar dhe përvetësuar, në veprime dhe vepra, sapo të jenë kthyer në shtëpi*”<sup>31</sup>. Ky lloji udhëtimi do t’i vinte më për shtat edhe Tat Tanushit. Një pelegrinazh sipas Chriss Hann-it<sup>32</sup> demonstroi unitet dhe luan rol në mbajtjen lart të standarteve morale, drejt të cilave i gjithë komuniteti nxitet që të aspirojë.

---

<sup>31</sup> F. Nietzsche, *Udhëtari dhe hija e tij*, Tiranë 2001, f. 98.

<sup>32</sup> C. Hann, *Antropologjia sociale*, 2009, f. 202-203.

Përmes pelegrinazhit besimtarët shpresojnë në çlirimin e shqetësimeve apo çrregullimeve të ndryshme fiziko-shpirtërore.

- *Ndikimi nga Ligjërimet e Shenjta dhe shkrimet me karakter biblik*

Duke iu referuar temave të trajtuara nga shkrimtarët e shekullit XX, rezulton si i pazakontë një rrëfim shqiptar, ku citohen ligjërimet e shenjta biblike përgjatë sistemit komunist, ndërkohë që slogani i Marksit se “*feja është opium për popullin*”, do të konsiderohej si pro qeverisë në pushtet.

Nëse ka një vepër letrare, apo një personazh rreth të cilit mund të themi se autori mund të jetë ndikuar, do të kishim veçuar Dostojevskin, me personazhin e tij kallogjerin *Zosimë*. Kemi seleksionuar këtë autor, jo vetëm si letrar, por dhe për faktin se pena e tij ka interpretuar përveç filozofisë jetësore, e cila paraqet degradimin e shtresave të popullsisë ruse, ku përmasat japin avantazhet për të zhbiruar rreth karaktereve nga më të veçantat, autori na ofron përmes veprës së tij edhe teologjinë e religjionit. Kallogjeri, thotë Dostojevski, merr shpirtin dhe vullnetin tuaj për ta futur në të tijin. Kështu JU lini me vetëdije gjithçka tuajën, në dorën e tij. Detyra e kallogjerit, sipas tij, nuk nënkupton thjesht bindje, por një rrëfim të përjetshëm të të gjithë të përkushtuarve dhe një lidhje mes tyre<sup>33</sup>. Pushteti i kallogjerit mbetet i pakufishëm dhe i paarritshëm.

Meqenëse Tat Tanushi vendos të bëjë jetën e një vetmitari, oshënari apo murgu, atëherë na u desh të hulumtonim rreth identitetit të një murgu. Kush ishte murgu i Dostojevskit: “...njerëz të etur për vetmi e lutje të zjarrta..., Ata e ruajnë të pastër e të papërlyer figurën e Krishtit, ashtu siç e kanë trashëguar nga etërit, nga apostujt e martirët dhe, kur të vijë koha, do t’ia kundërvënë atë së vërtetës së lëkundur të kësaj bote..., murgu heq dorë dorë nga kërkesat e tepërta e të panevojshme, nga dëshirat egoiste, i mposht ato me kokunjësinë dhe, me ndihmën e Zotit, siguron lirinë e shpirtit, gëzimin e shpirtit!...Mësojeni popullin pa zhurmë, pa bujë. Ky do të jetë dhe heroizmi juaj; populli e ka në zemër Zotin.”<sup>34</sup>. Pikërisht këtë lloji murgu na ka ofruar dhe Kuteli përmes Tat Tanushit të Bubutimës.

Në romanin e Dostojevskit shkurtimisht ofrohet një legjendë dhe ngjarje e vërtetë, të cilat në përmbajtje i përafrohen novelës së Kutelit. Po i paraqesim shkurtimisht ashtu siç janë në roman për të sjellë edhe një herë në vëmendje çështjen e besës:

<sup>33</sup> F. Dostojevski, *Vëllezërit Karamazov*, roman, f. 34.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 307-318.

Legjenda: *Tregojnë se dikur në kohë të lashta, një rishtar nuk iu bind kallogjerit të vet dhe u largua prej tij, nga Siria në Egjipt. Pas shumë heroizmash arriti të meritonte vdekjen e mundimshme. Kur e futën si shenjt kufomën në kishë dhe prifti thirri: 'Shpirtra të liq, dilni!', arkivoli me trupin e mëkatarit u shkëput nga vendi dhe doli jashtë nga tempulli. Kjo gjë u përsërit tri herë. Së fundi u mor vesh se ky njeri kish shkelur besën e dëgjësës, që larguar nga kallogjeri i vet, pra dhe nuk mund të falej pa lejen e tij, pavarësisht nga bëmat e pashembullta.*

Ngjarja: *një murg bashkohës i yni, ishte fshehur në Athonë për të shpëtuar. Kallogjeri i vet e udhëroi ta linte Athonën, të cilën murgu e quante vend të shenjtë e strehë të qetë dhe të shkonte më parë në Jeruzalem, për t'u lutur në atë vend të shenjtë, e pastaj të kthehej në Rusi, në Siberi. Murgu fatkeq vajti në Kostandinopojë tek patriarku i gjithëpushtetshëm dhe iu lut ta lironte nga përbetimi që kish dhënë, por tjetri iu përgjigj, se as ai vetë, patriarku i gjithësisë, nuk e lironte dot dhe askush tjetër nuk e shpëtonte nga përbetimi para kallogjerit të tij.<sup>35</sup>*

Në të dyja rastet kemi shkeljen e besës së dëgjësës apo një lloji bese të lidhur me kallogjerin. Le të themi se, këto besë të lidhura, kanë karakter fetar dhe tepër intim, që lidhen dhe zgjidhen vetëm mes dy personave, pra kjo lidhje bese nuk ka lidhje me komunitetin që i rrethojnë këto persona, ashtu siç ndodhte me besën e kanunit. Ato nuk paragjykojnë nga të tjerët, por ndërvaren nga njëri tjetri për të përfituar faljen apo lirin që kish lidhje me përbetimin. Pra ndryshe konceptohet besa me karakter fetar nga besa e kanunit tek shqiptarët.

Po t'i lexojmë me vëmendje, mes kallogjerit dhe murgut të Dostojevskit ka shumë ndryshime. Ndërsa në kontekstin shqiptar murgu dhe kallogjeri janë e njëjta gjë; "a unë murga" (= murgesha), "a unë nata", "mos më lër kallogre", janë shprehje që i dëgjon në vajet e Labërisë. Nga këto kontekste të shkëputura, nga këngët folklorike apo shprehjet popullore, kuptohet që fjala është për një njeri të cilit i ka ngjarë një fatkeqësi, që mund të jetë e barabartë me një vdekje, apo që ka mbetur vetëm fillikat.

Përsa i përket fjalës kallogjer tek Dostojevski dhe fjalës kallogre në vajet e Labërisë, janë me prejardhje nga greqishtja. Për këtë iu referuam

---

<sup>35</sup> *Po aty*, f. 34-35.

fjalorit etimologjik greqisht<sup>36</sup>: kallogjer [kalos-jeras], që vjen nga mesjeta dhe do të thotë: shenjt i mirë, i respektuar, pse jo ndoshta dhe fjala plak i urtë do të ishte një prej shqipërimeve që do t'i vinte më për shtat; ndërsa kallogre [kali-gria], që do të thotë plakë e mirë, së cilës përvoja e jetës i ka dhënë të drejtën për t'u patur në vëmendje nga bashkëfshatarët.

E sollëm në vëmendje këtë ndryshim mes dy fjalëve, të cilat në gjuhën shqipe kanë hyrë nga greqishtja, por në ligjërime kanë pësuar një transformim në kuptimin e tyre të drejtpëdrejtë.

Përgjatë rrëfimit do të veçonim gjuhën e autorit, që rrjedh pa u nxituar, duke shpresuar se leçitësi do të ketë durim të këndojë rrëfimin e tij. Këndimi dhe rrëfimi i shkojnë për shtat fare mirë termave religjiozë. Në sytë e popullit analfabet, prifti apo hoxha e lexonin tekstin duke e kënduar dhe prandaj, të lexosh do të thotë të këndosh. Njeri i kënduar do të thoshte njeri i arsimuar.

Në një sintezë të rrëfimit të Kutelit dhe Shkronjës siç e thotë ai, vendosëm të ndalemi tek mosha kur atij i ndodh e gjitha kjo gjëmë, pra tre vjet pas vdekjes së të shoqes, ai ishte një dyzetvjeçar, që sipas tij *do të thotë dy herë nga njëzet*. Edhe ne si Kuteli hapëm shkronjën dhe kënduam: “*Israeli do të endet dyzet vjet në shkretëtirë; 29-Kufomat tuaja do të bien në këtë shkretëtirë; ju të gjithë që jeni regjistruar nga mosha njëzet vjeç e lart, dhe që keni murmuritur kundër meje; 33- Dhe bijtë tuaj do të kullojnë kopetë në shkretëtirë dyzet vjet me radhë dhe do të mbajnë ndëshkimin për pabesitë tuaja derisa të treften kufomat tuaja në shkretëtirë*”<sup>37</sup>. Nëse i kthehemi një analize të shkurtër të thënies së Biblës mund të ndalemi tek çështja e hakmarrjes dhe ndëshkimit, të cilat të dyja kanë vend në rrëfimin e autorit. Hakmarrja që mund të jetë e fshehtë dhe e dukshme, kryhet për të vënë në vend nderin, ose për të ruajtur veten dhe zakonisht, nuk e njeh frikën, ndërsa ndëshkimi ndalon hakmarrjen dhe njeh frikën. Mos ndoshta dhe kjo ambivalencë ndjenjash tek Kuteli, hakmarrje – ndëshkim i krijon një ngjarje jete, të cilën e quan gjëmë.

Përsa i përket fjalës së artit, në lidhje me simbolikën e numrit 40, iu kthyem një analize të Kutelit në një vepër të Fan Nolit. Analiza e tij ndalet tek poezia me tematikë biblike *Moisiu në Mal*, të cilën e citon si vjershë turbullonjëse, ku përshkruhet tragjedia e Krye-Profitit të Israilit, të dënuar prej Zotit vetë. Vargjet e fundit të poezisë, të cilave po iu referohemi si më poshtë, besojmë se nuk kanë depërtuar tek Kuteli pa lënë gjurmë, pse jo,

<sup>36</sup> G. Babinoti, Γ. ΜΠΑ ΜΠΙΝΙΩΤΗ ΕΤΥΜΟΛΟΓΙΚΟ ΛΕΞΙΚΟ ΤΗΣ ΝΕΑΣ ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΓΛΩΣΣΑΣ, ΑΘΗΝΑ, 2010, f. 618.

<sup>37</sup> *Bibla*, Tiranë, 1991-1994, Numrat 14, f. 169.

ndoshta ka sekuenca që do të gjendeshin në rrëfimin e mëvonshëm prej tij: *Pse kaqe gjat, Zot, m'arratise? / Pse më përplase, më përpëlise? / Pse shpresën dyzet vjet m'a yshqeve / Dhe sot ma preve?*

Për Kutelin *Moisiu në Mal*, është një rrëfim biblik, ku ngjitja bëhet për të folur me Zotin, dhe për të hapur vizione të madhërishme dhe ushëtime dhembjesh në shpirt<sup>38</sup>. Duke iu referuar kësaj analize lind edhe pyetja: Nëse në rrëfimin e tij të gjëmës, Kuteli ka shtjelluar të njëjtën ide?

Ndërkohë na duhet të kujtojmë mesazhin e autorit, që përmes tropareve të shenjta, ballafaqon shërbëtorin e Kishës Tat Tanushin, me interpretimin e gabuar që i bën ai Librit të Shenjtë, ngaqë e këndon librin me kuptimin e mishit dhe jo të frymës, e trajtuar kjo nga Kuteli si gjëmë, për t'iu destinuar mosvdekjes, e që do të zgjidhet falë pelegrinazhit, si çlirues shqetësimesh dhe çrregullimesh fiziko-shpirtërore.

#### Konkluzion

Duke marrë shkas nga teoritë antropologjike, ku në themel qëndron njohja dhe raportet social-kulturore me njeriun, u munduam të paraqesim marrëdhëniet dhe sakrificat, që ndërmerren prej autorit, si qenie e lirë për të vepruar. Gjëma nuk është asgjë tjetër veçse një ngjarje: një hakmarrje, një ndëshkim, një ankim, një besim i lëkundur, një krim, një mëkat, që tek autori ka lënë një gjurmë. Me autoritetin e një pelegrini, autori, deklaron nënshtrimin e tij vetëm para vullnetit të Zotit, të cilin do ta paraqiste përmes kësaj novele duke zbritur fuqitë hyjnore në tokë, gjë e cila nga shkrimtarët apo poetët kishte shumë kohë që ishte bërë modë. Pasyqyrimi i ngjarjeve të kësaj novele, çon në njohjen e vetvetes në raport me të shkuarën, pse jo, dhe njohje për shoqërinë e ardhshme. Si këmbëngulje e autorit, na lejon ta konsiderojmë rrëfimin një mit, ku roli i së përjetshmes në raport me njeriun, krijon iluzione, herë magjike e herë dramatike, me motiv në vetvete, kujtesën. Mendojmë se autori e shkruan enkas këtë novelë në një kohë të vështirë në të cilën ndodhej Shqipëria dhe bota e letrave, duke ndërmarrë një mision në ritregimin e mitit përmes artit të fjalës, me qëllim rikthimin në vëmendje të filozofisë së Shkronjës, ku sqarimet dhe interpretimet qoftë të autorit apo lexuesit, do të mund të ndriçonin mendimet teologjike, të cilat fare mirë gjenden kaq shumë nëpër novelë, saqë mes tyre, ndonjë lexues do të tentonte të njëhte Zotin.

---

<sup>38</sup> M. Kuteli, *Mall e Brengë*, Me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit, Tiranë, 1943, f. 18.

**BIBLIOGRAFI**

- Babinoti, G., Γ. ΜΙΑ ΜΠΙΝΙΩΤΗ ΕΤΥΜΟΛΟΓΙΚΟ ΛΕΞΙΚΟ ΤΗΣ ΝΕΑΣ ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΓΛΩΣΣΑΣ, ΑΘΗΝΑ, 2010.
- Barnard, A. 2011, *Historia dhe teoria në antropologji*, Prishtinë, 2011.
- Dostojevski, F., *Vëllezërit Karamazov*, roman, 307-318, përkthyes Sokrat Gjerat, Tiranë, 1994.
- E drejta zakonore shqiptare*, Tiranë, 1989, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.
- Gjeçovi, Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1972, f. 120-121.
- Gjikaj, E. 2008, *Prania Historike dhe shpëtimi i hebrenjve gjatë Luftës*, ‘Motivi i hebreat shëtitës në tekstin e Kutelit’, f. 178-184.
- Gjoni, S., *Shtegtim në jetën dhe veprën e Mitrush Kutelit*, Tiranë, 2009.
- Hann, Ch. 2009, *Antropologjia sociale*.
- Herzog, E. 2000 [1948]. *Psyche and Death*, woodstock, Connecticut.
- Husband, B. W., *The Journal of Modern History*, Vol. 70, No. 1, 1998, pp.74-177, Soviet Atheism and Russian Orthodox Strategies of Resistance, 1917-1932.
- Kant, 2000. *Digital Bibliothek of Philosophy*, Berlin.
- Kuteli, M., *E madhe është gjëma e mëkatit...*, 2006, Botimi III.
- Kuteli, M., *Mall e Brengë*, Me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit, Tiranë, 1943.
- Nietche, F., *Udhëtari dhe hija e tij*, Tiranë, 2001, Shtëpia botuese ‘Bargjini’, përkthyer nga Taulant Hatia.
- Plasari, A., *Kuteli mes të gjallëve dhe të vdekurve*, Tiranë, 1995.
- Qazimi, A., *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Tiranë, 2012, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.
- Shopenhauer, A., *Metafizika e Dashurisë*, Phoenix, 1995, përkthyer nga Arion Hyesenbegas, f. 54.
- Uçi, A., *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi [N. Frashëri, Gj. Fishta, F. Konica, M. Kuteli, Migjeni]*, ‘Krijmtaria letrare e Mitrush Kutelit dhe lidhjet e saj me folklorin’, Shkup, 2003.
- Velianj, A., *Kushtëzimi artistik këngë-rit në folklor*, “Perla”, 2008/1.
- Zhiti, V., *Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar*, Tiranë, 2010.